



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:038163

Datë: 22.10.2019

Numri i dokumentit: 00594101

**P.nr.735/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me bashkëpunëtoren profesionale të kësaj gjykate Teuta Spahija, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.F. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.887/2018, të datës 15.10.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur **me datë: 18.10.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë, ndërsa me datën 22.10.2019 e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**E.Z.**, nga i ati F., e ëma M., e gjinisë P.i, data e lindjes..., në Gjakovë, ku edhe tani banon i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datë 03.07.2018, rreth orës 22:15 minuta, afër gjimnazit “H.D.” në Gjakovë, i akuzuari pa autorizim ka poseduar narkotik substanca ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128 dhe atë të llojit marihuanë, në atë mënyre që pas kontrollit rutinor nga hetuesit e DHTN-Gjakove, tek i akuzuari brenda një pako të cigareve “Lucky Strike” është gjetur një qese najloni e mbushur me substancë në formë bari, ngjyre të gjelbër e dyshuar për narkotik të llojit marihuane, e cila është sekuestruar nga ana e zyrtareve policor, ashtu që pas ekspertimit ka rezultuar të jete substancë e llojit kanabis (marihuane) me peshë të përgjithshme prej 0.42 gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 58, 62, 69, 73, 74 dhe nenit 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **obligohet** i akuzuari E.Z. të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe

## D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

Ashtu që konfiskohen: substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahydrokanabinol (THC), në peshë neto të përgjithshme prej 0.42 gram, si objekt i veprës penale.

**Detyrohet** i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër: PP/II.nr.887/2018, të datës 15.10.2018, kundër të akuzuarit E.Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit E.Z. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari E.F., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe ka shtuar se jam penduar tepër për këtë veprim dhe i premtoi Gjykatës që nuk do të përsëris veprimet të tilla, dhe do të shmangem çdo veprim të këtillë në të ardhmen.

Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet të cilat janë bashkangjitur aktakuzës.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit të fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në te cekurat me larte gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar kete gjendje faktike:

-se i akuzuari E.Z., me dashje ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohen vendin dhe mënyrën e përshkruar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni është parashikuar se “Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”, andaj gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: së është i moshës relativisht te re 22 vjeçare, i pa pune, student, i gjendjes se dobët ekonomike, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin i fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se dënimin me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të

shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Vendimin për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit me kusht

Gjykata ka marr vendim konform nenit 58 të KPRK-së, që mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, nga se gjykata konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e dënimit me kusht të shqiptuar nga gjykata do të arrihet më së miri përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

7. Dënimi plotësues

Gjykata ndaj të akuzuarit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimin e substancës narkotike, konform neneve 62, 69 dhe 275 par.3 të KPRK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm shpenzimet e paushallit gjyqësor duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.735/18, me datë 18.10.2019**

**Bashkëpunëtorja profesionale,**  
**Teuta Spahija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.